



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 korrik 2012
Nr.ref.:RK/273/12

AKTVENDIM PER PAPRANUESHMERI
në

Rastin Nr. KI39/12

Parashtruesi

Selver Dërmaku

Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës A. nr. 693/2011 të 23 shtatorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almira Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtrues i Kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Selver Dërmaku, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë.

Vendimi gjyqësor i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik me të cilin pretendohen shkeljet e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: "Kushtetuta") është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 693/2011 i 23 shtatorit 2011 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), të cilin parashtruesi e ka pranuar më 1 tetor 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së lëndës/kërkesës së parashtruar më 13 prill 2012 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: "Gjykata") është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. nr. 693/2011 të 23 shtatorit 2011, qe ka të bëjë me të drejtën për pension të personave me aftësi të kufizuara.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 16 dhjetorit 2008, i hyrë në fuqi më 15 janar 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe Rregulli 28 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Ankesa e parashtruesit

5. Parashtruesi i kërkesës ankohet se Komisionet mjekësore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme: MPMS) ia kanë refuzuar në mënyrë joligjore të “drejtën për pension të personave me aftësi të kufizuara” edhe pse e njëjti pretendon se i kishte plotësuar kushtet për një pension të tillë, ndërsa Gjykata Supreme me Aktgjykimin A. nr. 693/2011 të 23 shtatorit 2011, duke refuzuar padinë e tij lidhur me këtë çështje pretendon se ka bërë shkelje të të drejtave të tij kushtetuese

Procedura në Gjykatë

6. Më 13 prill 2012 Gjykata Kushtuese pranoi kërkesën parashtruar nga z. Selver Dërmaku dhe e regjistroi atë me nr. KI 39/12.
7. Më 23 prill 2012, Kryetari, me vendimin GJR. 39/12 caktoi Gjyqtar raportues, gjyqtaren Dr. Gjyljeta Mushkolaj. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me vendimin KSH. 39/12, caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues në përbërje të gjyqtareve: 1. Snezhana Botusharova (kryesuese), 2. Ivan Čukalović (anëtar) dhe 3. Dr. Iliriana Islami (anëtare).
8. Më 29 maj 2012 Gjykata, njoftoi parashtruesen e kërkesës, gjithashtu dhe Gjykatën Supreme, për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 2 korrik 2012, Kryetari, me vendimin GJR. 39/12 caktoi Gjyqtar raportues, gjyqtarin Robert Carolan, që e zëvendëson gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj, meqë ajo përfundoi mandatin e saj si gjyqtare në Gjykatë më 26 qershor 2012. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me vendimin KSH. 39/12, caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues në përbërje të gjyqtareve: 1. Altay Soroy (kryesues) që e zëvendëson gjyqtaren Iliriana Islami, që po ashtu e përfundoi mandatin si gjyqtare në Gjykatë më 26 qershor 2012, 2. Snezhana Botusharova (anëtare) dhe 3. Ivan Čukalović (anëtar).
10. Më 10 korrik 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës nga 23 korriku i vitit 1983 ka qenë përfitues i pensionit invalidor, kategorizuar me shkallën e parë të invaliditetit. Këtë të drejtë ia kishte njohur BVI e sigurimit pensional invalidor të Kosovës, përkatësisht bashkësia e SHERB-PROF-I. nr. 28043.
12. Më 1 janar 2004, MPMS, përkatësisht Departamenti i Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: DAPK) bazuar në dokumentacionin e dhe provat e ofruara nga parashtruesi, ia njohu të drejtën për përfitimin e pensionit invalidor për faktin që parashtruesi i kishte plotësuar kushte sipas Ligjit 2003/23 për Pensionet e personave me aftësi të kufizuara.

13. Më 13 prill 2007, DAPK, bazuar në vlerësimin e Komisionit Mjekësorë, nxori Vendimin nr. 5001462, më ç'rast ia refuzoi kërkesën parashtruesit për vazhdimin e të drejtës së përfitimit të pensionit invalidor. Kundër këtij vendimi parashtruesi kishte ushtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të DAPK.
14. Më 30 korrik 2007, DAPK, përkatësisht Komisioni i Ankesave me Vendimin nr. 5001462, aprovoi ankesën e ushtruar nga parashtruesi dhe ia njohur serish të drejtën e përfitimit të pensionit të personave me aftësi të kufizuara.
15. Më 1 tetor 2008, DAPK, pasi që Komisioni Mjekësor kishte vlerësuar se parashtruesi edhe me tutje i plotëson kushtet për përfitimin e pensionit të personave me aftësi të kufizuara sipas nenit 3 të ligjit 2003/23, nxori vendimin nr. 5001462 dhe vendosi që, parashtruesit serish t'i vazhdohej e drejta e përfitimit të pensionit invalidor edhe për tri (3) vite të ardhshme, duke e lënë të hapur mundësinë që pas kalimit të afatit tre vjeçar, parashtruesi, t'i nënshtrohej rishqyrtimit dhe rivlerësimit të gjendjes, që kishte të bënte me të drejtën e përfitimit të pensionit invalidor, duke filluar nga data e fitimit të kësaj të drejte.
16. Më 16 mars 2011, DAPK me Vendimin nr. 5001462, bazuar në vlerësimin e Komisionit Mjekësor, ia refuzoi parashtruesit kërkesën për vazhdimin edhe me tej të përfitimit të pensionit invalidor, me arsyetimin se, "te i njëjti nuk ekziston aftësia e kufizuar e plote dhe e përhershme". Kundër këtij vendimi parashtruesi kishte ushtruar ankesë në Komisionin e Ankesave që vepron në kuadër të DAPK.
17. Më 6 maj 2011, DAPK, bazuar në rivlerësimin e Komisionit të Ankesave, nxori Aktvendimin nr. 5001462 dhe vendosi për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit Mjekësor, duke ia refuzuar kështu parashtruesit të drejtën e përfitimit të pensionit invalidor, për personat me aftësi të kufizuara. Komisioni i Ankesave vendimin e Komisionit Mjekësor e kishte konsideruar si plotësisht të bazuar dhe në përputhje me ligjin 2003/23 për Pensionet e personave me aftësi të kufizuara, për faktin që ky komision vlerësoi që parashtruesi nuk i plotëson edhe më tej kushtet për përfitimin e pensionit invalidor, siç parashihet me nenin 3 të ligjit nr. 2003/23. I pakënaqur me aktvendimin e organit administrativ të shkallës së dytë parashtruesi ushtroi padi për iniciimin e Konfliktit Administrativ në Gjykatën Supreme.
18. Më 23 shtator 2011, Gjykata Supreme, duke vepruar sipas padisë së ushtruar nga parashtruesi i kërkesës për iniciimin e Konfliktit Administrativ, nxori Aktgjykimin A.nr.639/2011, më ç'rast refuzoi padinë e ushtruar kundër MPMS, përkatësisht DAPK me nr. të dosjes 5001462 të 6 majit 2011. Gjykata Supreme, kishte konstatuar se organet e administrative drejt kishin zbatuar dispozitën e nenit 3 të ligjit 2003/23 për Pensionet e personave me aftësi të kufizuara, për faktin që komisioni kishte vërtetuar që parashtruesi nuk i plotëson më tej kushtet ligjore për njohjen e të drejtës për pensionin e personave me aftësi të kufizuara.

Pretendimet e parashtrueses

19. Parashtruesi i kërkesës, pretendon se, Gjykatës Supreme, me Aktgjykimin A. nr. 29/2011 të 15 shkurtit 2011, duke ia refuzuar përfundimisht të drejtën për njohjen e statusit të personit me aftësi të kufizuar ka bërë shkelje kushtetuese të të drejtave të tij, të garantuara me: Nenin 51.2 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale], Kapitullin VII, [Sistemi i Drejtësisë], Nenin 102 paragrafi 3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], Nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejte i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtarë]; dhe Nenin 13 [Kartës Sociale].

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Në mënyrë që Gjykata, të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtrueses, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregulloren e punës së Gjykatës.
21. Gjykata, vëren që vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës është Aktgjykimi A. nr.639/2011 i 23 shtatorit 2011, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 1 tetor 2011. Ndërsa, parashtruesi kërkesën në Gjykatë e dorëzoi më 13 prill 2012, që nënkupton se kërkesa është dorëzuar jashtë afatit katër (4) mujor, të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, sepse kërkesa është dashur që të dorëzohet në Gjykatë, jo me vone së 1 shkurti 2012.
22. Lidhur me këtë , Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [..].”

23. Parashtruesja, nuk ka arsyetuar në asnjë mënyrës vonesën e parashtrimit të kërkesës. Andaj, barra e të provuarit bie mbi palët që parashtrojnë kërkesën e tyre në Gjykatë. Nga ky këndvështrim, Gjykata, duhet të konsiderojë se kërkesa është parashtruar jashtë afatit të paraparë me ligj. Prandaj, kërkesa është e papranueshme.
24. Rrjedhimisht, Kërkesa, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, Rregullin 56. (2) të Rregullores së Punës është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, më 3 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t’u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues


Robert Carolan

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese


Prof. Dr. Enver Hasani